



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR PR/VENDIMIN: “PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE, BASHKIA SHKODËR 2024-2029”

Konsultim publik : I Hapur

Data : 27.08.2024

Ora : 10.00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 12, nga të cilat 2 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : “Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia Shkodër 2024”

Pjesëmarrës : Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli. Drejtues dhe Specialistë të Bashkisë Shkodër, qytetarë dhe grupe interesi.(Bashkëlidhur listëprezenca)

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Relaton në mënyrë analitike sipas materialit të përgatitur **Znj. O.Domnori**, specialiste pranë drejtorisë së Shërbimeve publike në Bashkinë Shkodër.

Fjalën e merr **Z.Plarent Anamali**, anëtar i Këshillit Bashkiak, i cili përgëzon stafin për punën e kryer në përgatitjen e këtij plani dhe shtron disa pyetje:

- Çfarë rezultatesh janë arritur nga nga plani i vjetër i cili ka përfunduar në 2022?
- Përsa i përket planit të ri në krahasim me atë të vjetër, cilat janë risitë në shërbime që sjell ky plan?
- Po ashtu ai kërkon të dijë se kur është miratuar strategjia kombëtare lidhur me këtë plan?

- Gjithashtu ai pyet nëse është parashikuar ndonjë mjet pastrimi shtesë në kulmin e sezonit, pasi konstatohet që pikat e grumbullimit janë të mbingarkuara.
- Në lidhje me pastrimin 2 herë në javë në njësitë administrative, si është llogaritur kjo frekuencë?
- Përsa i ndarjes së mbetjeve dhe kompozimit të tyre a është menduar që të bëhet informim i popullatës për këtë?

Përgjigjet në mënyrë të detajuar **Znj.Ina Xhakoni**, specialiste e fushës dhe pjesë e grupit të punë në përgatitjen e planit. Ajo shprehet se strategjia kombëtare është miratuar në 2020 dhe i përmban të gjitha objektivat. Gjithashtu shton se indikatorët e performancës së planit të vjetër janë pjesë edhe e planit të ri. Një plan ky prej 170 faqesh. Ajo që vjen të përmendet është fakti që objektivi i reciklimit nuk është realizuar pasi është kosto e shtuar dhe tarifim më i lartë për qytetarët.

Përsa i përket incentivimit të popullatës po punohet me drejtoritë përkatëse.

Në lidhje me frekuencën e pastrimit përgjigjet **Znj.Domnori** duke thënë se Bashkia Shkodër ka menduar që një mjet pastrimi shtesë të përdoret në pikun e sezonit, duke parë nevojën dhe të mbulojë me shërbim zonat problematike.

Z.Luli pyet se sa përqind e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane mbulohet nga tarifa e pastrimit që paguajnë qytetarët?

Përgjigjet përsëri **Znj.Donori** duke sqaruar se mbulimi i koston nga tarifimi ka qenë 98% për vitin 2023.

Fjalën e merr **Z.Kallaçi**, administrator i Rajonit nr.4 dhe kërkon që të rishihet orari i pastrimit të mbetjeve pasi kemi shpeshherë ankesa nga banorët.

Z. Ismet Haxhija, administrator i Njësisë administrative Gur i Zi kërkon gjithashtu që të rishihet dhe të ketë shtim të frekuencës së pastrimit në Njësinë administrative pasi dy herë në javë janë të pamjaftueshme.


Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka . Dëgjesa për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia Shkodër 2024",deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Mbajtësi i procesverbalit:

Irma Sulishti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

DËGJESË PUBLIKE: Për projekt vendimin “ Për Miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane , Bashkia Shkodër 2024-2029”

Datë: 27.08.2024

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1	ELIS CAMAJ	"MARK LULA"	0693113558	elisa.camaj@yahoo.com	
2	ALBI GULAJ	"Salo Halili"	0697717877	albiculaj@yahoo.com	
3	DOVKA NDOJA	ADM. Laj. Nr. 5	0693803193	donandola@gmail.com	
4	EDUARD SHEMA	Lagje Nr. 4	0694803674	eduard.sHEMA@gmail.com	
5	ANTON DEDA	ADM. 2.3	0695324024	Anton.Deda@bashkishtoket.gov.q	
6	Mahen Dabllaci	Kodu Laj. 4	06766003026		
7	Basim Hoxha	Shkodër	692404375		
8	PLARENT AWAMALI	SHKODËR	0696354123	enand.plarentawamali@gmail.com	
9	EDVIN HAXHA	SHKODËR	0686028418	edvin.hoxha@telekom.al	
10	JONA XHAWANI	SHKODËR	0697611662	mon.xhawani@group.de	
11	Murat Haxhiu	SHKODËR	0673415820		
12	Fitbardha Kuci	Shkodër	0676305001	fitbardha.kuci@yahoo.com	